

# RAPORTI I SHPENZIMEVE

janar - shtator 2007

KOMUNA E PRISHTINËS

## IZVESTAJ TROSKOVA

januar - shtator 2007


OSPTINA PRISTINE

## EXPENSES REPORT

january - September 2007

MUNICIPALITY OF PRISTINA

RAPORTI I SHPENZIMEVE janar - shtator 2007 KOMUNA E PRISHTINËS



# RAPORTI I SHPENZIMEVE

janar - shtator 2007

KOMUNA E PRISHTINËS

315

## IZVESTAJ TROSKOVA

januar - shtator 2007

OSPTINA PRISTINE

712

## EXPENSES REPORT

january - September 2007

MUNICIPALITY OF PRISTINA

1219

# RAPORTI I SHPENZIMEVE

janar - shtator 2007

KOMUNA E PRISHTINËS

Raporti është botuar në kuadër të Projektit : “Paraja Publike-Publike”.  
Projekti është mbështetur financiarisht nga USAID/IREX në kuadër të  
programit për Shoqërinë Civile, që implementohet nga ATRC.  
Këtë projekt e ka realizuar OJQ Mileniumi i Ri me seli në Prishtinë.

**Raporti është përgaditur nga:**  
Mentor Morina

**Përkthimi:**  
Shqip/Serbisht:  
Fanol Shehu

**Dizajni & shtypi:**  
VIPRODUCT

**Botues :**  
OJQ “Mileniumi I Ri”  
Prishtinë

**Të drejtat autoriale:**

Botimi është pronë e botuesit, të gjitha të drejtat e përdorimit të  
këtij botimi i përkasin OJQ Mileniumi i Ri. Asnjë pjesë apo teksti  
në terësi nuk mund të merret pa lejen paraprake ©

Mileniumi i Ri 2007.

## Disa fjalë për OJQ Mileniumi i Ri

Mileniumi i Ri është OJQ lokale e themeluar në vitin 2001 në Prishtinë. MR ka punuar në shumë fusha dhe ka realizuar shumë projekte të mbështetura nga donatorë të ndryshëm. Që nga viti 2005 MR punon me sferën lokale, përkatësisht në nivelin lokal.

### MISIONI

Mileniumi i Ri është organizatë jo-fitimprurëse e cila punon për të forcuar rolin e shoqërisë civile në Kosovë, me qëllim të shtytjes së proceseve pozitive përpara, nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, pasqyrimin e transparencës në institucionet publike, luftimin e dukurive negative në shoqëri dhe avokimin e vazhdueshëm për të drejtat qytetare dhe çështjet me interes publik.

### OBJEKTIVAT

- Të avancojë rolin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile (OJQ-ve), në të gjitha proceset shoqërore të cilat janë me interes për shoqërinë kosovare;
- Përmirësimi i kushteve të mjedisit, zhvillimit të vendit përmes fushatave dhe kampanjave të ndryshme, në bashkëpunim me institucionet, shoqërinë, shoqatat, grupet e ndryshme të interesit dhe median;
- Monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së institucioneve publike dhe bërjen publike, shpenzimin e taksave të qytetarëve;

### STAFI

Drejtor Ekzekutiv:  
Nehat Bllacaku

Koordinator i Projekteve:  
Altin Ademi

Asistente  
Teuta Rexhepi

Kryesues i Bordit  
Gjelbrim Berisha

### Adresa

Dardani, Rruga : “Lekë Dukagjini”, Objekti i Bashkësisë Lokale, nr 3  
Telefon : 038/545 633 Mobil 044/307 533  
Email : ojqmileniumiiri@yahoo.com ojqmileniumiiri@hotmail.com  
10000 Prishtinë Kosovë

## PARATHËNIE

*Duke shfletuar këtë*

*raport, ju do të mund të thoni, sa i mangët dhe sa pak informata qenkan këtu ! Por, raporti është i tillë, sepse vetëm këto janë informatat që ka nxjerrë Kuvendi Komunal i Prishtinës për këtë periudhë, madje këto informata nuk janë publikuar por na janë dhënë pas shumë kërkesave. Asnjë raport në lidhje me punën, realizimin e projekteve, miratimin e vendimeve apo miratimin e projekteve të ndryshme, nuk është publikuar. Të kota kanë qenë kërkesat tona për të ditur për realizimin e objektivave të vitit 2007, të kota kanë qenë edhe nismat tona për të takuar shumicën e drejtorëve të KK-së. Prandaj duhet thënë që qytetarët e Prishtinës, nuk janë informuar fare se si i ka shpenzuar mjetet gjatë kësaj periudhe KK-ja, cilat projekte janë realizuar, cilat kanë mbetur pa realizuar dhe kur do të realizohen. Gjatë këtij viti komuna u bë e gjallë vetëm në fillim të shtatorit, ku filluan punimet papritmas në pjesën më të madhe të rrugëve. Kjo ska se si të arsyetohet ndryshe veçse punë para fushatës parazgjedhore. Për muaj të tërë rrugët e Prishtinës janë të bllokuara të mbushura me rërë dhe makina të rënda. Madje në disa rrugë edhe pse nuk kanë filluar punimet janë vendosur grumbuj të rëres për të tërhequr vëmendjen se këtu po punohet. Askush nuk i ka informuar banorët se rruga e tyre për muaj të tërë do të bllokohet, askush nuk ka kërkuar takim me qytetarët për ti informuar ata. Të vetmet kanë qenë mediat që kanë publikuar lajme se do të fillojnë punimet. Prandaj neve na është dashur të publikojmë këtë raport me këto informata që kishim për dy arsye. Në njëren anë për të kryer punën tonë të cilën e kemi të paraparë dhe në anën tjetër për ti informuar qytetarët me mënyren e shpenzimit të fondeve publike dhe me ecurinë e këtyre shpenzimeve. Shpresojmë që raporti sadopak do të ju jap një rezymë të punëve që ka*

Prishtinë  
Nëntor 2007

Nehat Bllacaku  
Drejtor Ekzekutiv

## 1. Buxheti i Komunës së Prishtinës

Komuna e Prishtinës për vitin 2007 ka një buxhet rreth 26,300,000 €. Granti qeveritar merr pjesë me 19,300,000 €, ndërsa të hyrat vetanake janë të vlerësuara prej 7,000,000 €. Komuna ka të aprovuar stafin prej 4,902 punëtorëve, për të gjitha programet. Në bazë të të dhënave në dispozicion të nxjerra nga KK Prishtinës ekziston edhe një shumë e buxhetit në dispozicion (të hyrat vetanake të bartura), shumë e cila është bartur nga viti i kaluar në shumë të mjeteve financiare 6,077,559 €. Pra në bazë të kësaj buxheti i Komunës së Prishtinës në dispozicion për t'u shpenzuar për vitin 2007 është siguruar nga tri lloje të të hyrave, përmes grantit të përgjithshëm ndërqeveritar, të hyrave vetanake dhe të hyrave vetanake të bartura nga viti 2006.


## 2. Analizë e shpenzimeve të mjeteve buxhetore për periudhën janar-shtator 2007

Nga të dhënat të siguruar rreth shpenzimit dhe menaxhimit të mjeteve buxhetore në dispozicion nga KK Prishtinës për periudhën Janar-Shtator 2007, është vërejtur se në disa kategori të shpenzimeve shumica e mjeteve financiare në dispozicion nuk janë shpenzuar sipas rrjedhës së parasë dhe alokimeve të bëra. Buxhetin e shpenzuar dhe të alokuar për periudhën 9 mujore sipas kategorive ekonomike për Komunën e Prishtinës do ta paraqesim në tabelën nr.1

Tabela 1; Mjetet e alokuara dhe të shpenzuara për periudhën janar-shtator 2007

Kategoritë ekonomike	Buxheti	Alokimet	Shpenzimet	Alokimet e pa shpenzuara
Pagat	12,067,669.00	9,120,030.00	7,772,717.60	1,347,313.06
Mallra dhe sher	4,429,243.00	3,222,603.00	3,468,941.50	(246,337.53)
Shp. Komunale	1,445,009.00	1,212,756.67	1,134,978.36	77,778.31
Subvencione	566,053.41	566,053.41	458,718.88	107,334.53
Shp. Kapitale	13,869,960.00	13,769,960.00	3,034,401.79	10,735,558.37
<b>TOTALI</b>	<b>32,377,935.63</b>	<b>27,891,404.87</b>	<b>15,869,758.13</b>	<b>12,921,646.74</b>

Në bazë të raportit të paraqitur në tabelën nr.1 dhe të dhënave në dispozicion analizat dhe parashikimet tona bëjnë të njohur se do të kemi një suficit në fund të vitit fiskal buxhetor. Këtë mund ta shikojmë edhe në tabelë, ku gjatë kësaj periudhe 9 mujore nga gjithsej 27,8 milion euro të alokuara janë shpenzuar vetëm 15,8 milion euro, ndërsa gjithsej mjete të alokuara të shpenzuara kemi 12,9 milion euro. Përveç në kategorinë e shpenzimeve në mallra dhe shërbime ku kemi tejkalim të shpenzimeve në bazë të alokimeve, tek të gjitha kategoritë tjera ekonomike të shpenzimeve është vërejtur ngecje në realizimin e buxhetit në bazë të alokimeve. Kjo ngecje është shumë e theksuar tek kategoria ekonomike shpenzimet kapitale, ku nga gjithsej 13,7 milion euro për realizimin e projekteve të ndryshme kapitale në periudhën 9 mujore janë shpenzuar 3.0 milion euro, pra vetëm rreth 22 % e buxhetit në dispozicion. Nga kjo mund të vlerësojmë se kemi mosrealizim dhe keq menaxhim të buxhetit të Komunës së Prishtinës, sidomos në realizimin e projekteve kapitale, projekte të cilat duhet t'u kthehen taksapagueseve dhe qytetarëve të kësaj komune s'i kompensim, në zhvillimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve sa më të mira për jetesë nga taksat dhe tatimet që i paguajnë. Për të kuptuar më lehtë raportin në mes të alokimeve dhe shpenzimeve kemi paraqitur grafikun nr.1




Grafiku nr 1; Raporti në mes të buxhetit të alokuar dhe shpenzuar

## 3. Buxheti i aprovuar i Komunës Prishtinës sipas programeve për vitin 2007

Buxheti i aprovuar i Komunës së Prishtinës për vitin 2007 siç është cekur edhe më lartë përbëhet nga dy lloje të financimeve pra nga granti qeveritar në kuadër të të cilit bëjnë pjesë granti për administratë të përgjithshme, granti për arsim dhe granti për shëndetësi, të cilët përbëjnë shumën prej 19,191,249.00 euro. Pjesa tjetër e buxhetit të aprovuar është siguruar nga të hyrat vetanake, të cilat janë vlerësuar që të jenë rreth 7,000,000.00 euro. Buxhetin e aprovuar të Komunës së Prishtinës sipas programeve dhe llojet e burimeve të financimit, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve do ta paraqesim në tabelën nr.2, ndërsa llojet e burimeve të financimit sipas granteve do t'i paraqesim në grafikun nr.2

Burimet e financimeve për vitin 2007 sipas granteve



Grafiku nr 2; Llojet e burimeve të financimit të buxhetit të Komunës Prishtinës për vitin 2007

Grafiku i lartshënuar na jep të kuptojmë se burimet me të larta të financimit vijnë nga granti për arsim rreth 35 %, pastaj të hyrat vetanake me 27 %, granti i përgjithshëm me 21%, granti i shëndetësisë me 12% dhe granti stimulues me 5%.

## 1. Buxheti i Komunës së Prishtinës

Siç u përmend edhe më lartë për të kuptuar më mirë shpërndarjen e buxhetit të aprovuar do të paraqesim një tabelë me të dhënat e buxhetit të aprovuar të shpërndarë nëpër programe apo drejtori sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

Prishtinë	616	Drejtoritë/Programet	Staf 2007	Paga dhe Shtesa	Mallëra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvenci one dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
<b>Shpenzimet</b>									
	160	Z. Kryetarit	6	51,620	0	0	0	0	51,620
	190	Z. Kryeshefit	18	58,913	0	0	0	0	58,913
	170	Administrata	151	566,478	1,578,530	410,000	300,000	100,000	2,955,008
	175	Buxhet,Financa	92	191,867	0	0	0	2,256,761	2,448,648
	480	Ekonomi	15	41,690	50,000	-	-	-	91,690
	850	Kulture, Rini, Sport	75	165,029	-	-	-	810,000	975,029
	550	Ambient	4	11,009	-	-	-	-	11,009
	180	Komunikim, Mardh.me publikun, Demokratizim	2	8,211	-	-	-	-	8,211
	660	Urbanizem	31	76,480	-	-	-	455,000	531,480
	650	Gjeodezi, Kadaster, Prone	29	68,160	-	-	-	-	68,160
	177	Inspekcioni	64	153,876	40,000	-	-	45,000	238,876
	490	Zhvillim Ekonomik, Planifikimi, Rekonstruimi, Investimet publike	-	-	-	-	-	-	-
	470	Agrokultur, Pylitari, Zhvillim Rural	8	24,942	50,000	-	-	710,000	784,942
	185	Sherbime Publike	24	64,319	45,000	-	-	1,600,000	1,709,319
	665	Pronesore-Juridike	6	18,339	-	-	-	-	18,339
	167	Prokurimi	6	16,923	-	-	-	-	16,923
	195	Zyra Lokale e Komuniteteve	24	57,870	100,000	13,048	-	77,927	248,845
	198	Zyra per Kthimin e Komuniteteve	2	5,927	258	-	-	-	6,185
	340	Zjarrfikesat	127	228,556	70,000	44,262	-	330,000	672,818
	350	Mbrojtje Civile dhe Emergjence	22	57,754	-	-	-	50,000	107,754
	920	Arsim dhe Shkence	3,325	7,841,300	1,523,445	557,699	-	1,100,000	11,022,444
	730	Shendetesia, Mireqenje Sociale	871	2,281,697	718,339	260,000	-	905,000	4,165,036
<b>Totali i shpenzimit</b>			<b>4,902</b>	<b>11,990,980</b>	<b>4,175,572</b>	<b>1,285,009</b>	<b>300,000</b>	<b>8,439,688</b>	<b>26,191,249</b>
<b>Burimet e financimit</b>									
	Granti i Pergjithshëm			1,867,983	1,728,788	467,310	-	1,403,561	5,467,642
	Granti Stimulues			-	-	-	-	1,431,127	1,431,127
	Granti i Shëndetësisë			2,036,697	718,339	260,000	-	205,000	3,220,036
	Granti i Arsimit			7,841,300	673,445	557,699	-	-	9,072,444
	Të hyrat Vetanake			245,000	1,055,000	-	300,000	5,400,000	7,000,000
<b>Total i financimit</b>				<b>11,990,980</b>	<b>4,175,572</b>	<b>1,285,009</b>	<b>300,000</b>	<b>8,439,688</b>	<b>26,191,249</b>

Tabela 2;Buxheti i aprovuar i Komunës së Prishtinës sipas programeve dhe kategorisë së shpenzimeve

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën nr.2 e cila është siguruar nga Libri i Buxhetit për vitin 2007, mund të shikohet buxheti i distribuuar nëpër secilin program apo drejtori të komunës dhe për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve. Programet apo drejtoritë për të cilat është planifikuar dhe ndarë buxhet më i lartë janë; Arsimi me buxhet mbi 11.0 milion euro, Shëndetësia me 4.1 milion euro, Administrata me 2.9 milion euro, Buxhet dhe Financa me 2.4 milion euro, pasojnë Shërbimet Publike me 1.7 milion e kështu me radhë.

Në bazë të shpërndarjes dhe aprovimit të buxhetit sipas tabelës së lartshënuar mund të vlerësojmë se në disa programe si pasojë e planifikimeve të dobëta dhe mosparaqitjes së projekteve është ndarë një shumë e mjeteve minimale apo nuk janë ndarë mjete buxhetore për vitin 2007. Mund të vëreni se ndër programet apo drejtorit për të cilat nuk janë ndarë apo aprovuar mjete buxhetore janë; Ambienti, Ekonomia dhe Urbanizmi.

Nga kjo mund të vlerësojmë se kemi një dështim në planifikimet buxhetore të menaxhmentit të Komunës së Prishtinës, pasi që ndër qëllimet dhe objektivat kryesore të Komunës së Prishtinës ishin; zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës, përmirësimi dhe kujdesi ndaj ambientit ku jetojnë qytetarët dhe zhvillimi/mbështetja e komunitetit të biznesit.

Pra nëse e analizojmë buxhetin në dispozicion të ndarë për këto programe apo drejtori dhe nevojave për zhvillim në vitin 2007, atëherë mund të vlerësojmë se nuk mund të kemi një përmirësim dhe kujdes ndaj ambientit ku jetojnë qytetarët me një buxhet të ndarë në shumë prej 11,000.00 euro për vitin 2007, në një komunë me mbi 500,000 mijë banorë.

## 4. Projektimet e politikës fiskale 2007-2009


Projektimet e politikës fiskale për periudhën 2007-2009, sipas grantit ndërqeveritar për vitet vijuese do ta paraqesim në tabelën nr.3.

Tabela 3;Projektimet e politikës fiskale sipas grantit ndërqeveritar për periudhën 2007-2009


Programet	Buxheti 2006	%	Buxheti 2007	%	Buxheti 2008	%	Buxheti 2009	%
Administrata komunale	6,237,242	*	6,208,408	-1	6,326,342	+1	6,515,921	+1
Arsimi	9,017,208	*	8,853,492	-1	8,853,492	*	8,853,492	*
Shëndetësia	3,220,036	*	3,220,036	*	3,220,036	*	3,220,036	*

Nga tabela e projekteve të politikave fiskale për periudhën 2007-2009 vërehet një zvogëlim i vogël i granteve nga viti 2006 në vitin 2007, e cila vazhdon me një rritje konstante për vitet në vijim. Përveç programit për Administratë Komunale i cili kishte një ndryshim të vogël nga viti 2006 në 2007, e që vazhdon me një rritje me +1% në vitin 2008 dhe +1% në 2009, rënie të njëjtë kemi edhe tek programi i Arsimit, ku më pas vazhdon pa ndonjë ndryshim. Sa i përket programit të shëndetësisë në bazë të projekteve të lartshënuar në tabelën nr.3 nuk është vërejtur ndonjë ndryshim rritje apo zvogëlim të mjeteve buxhetore për periudhën 2007-2009.

Projektimet e politikës fiskale sipas grantit ndërqeveritar do t'i paraqesim edhe përmes grafikut nr.3



Grafiku 3;Projektimet e politikës fiskale sipas programeve 2007-2009



Grafiku 4; Lakorja e krahasimit të planifikimit të të hyrave për vitin 2006 dhe 2007

### 5. Krahasimi i të hyrave të planifikuara

Sa i përket planifikimit të të hyrave vetanake komunale buxhetore parashihen të realizohen në bazë të rregullores komunale për tarifa dhe ngarkesa, rregullores së tatimit në pronë dhe të predispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale.

Krahasimet e planifikimeve të të hyrave vetanake sipas llojit për vitin 2006 dhe 2007, do t'i paraqesim në tabelën nr.4

Tabela 4;Krahasimi i planifikimi të të hyrave të planifikuara në mes të vitit 2006 dhe 2007

Nr	Përshkrimi	Planifikuar 2006	%	Planifikuar 2007	%
1	Të hyrat tjera	47.000,00	0,59	50.000,00	0,43
2	Administrata	125.000,00	1,56	150.000,00	1,28
3	Të hyra nga kadastri	200.000,00	2,50	500.000,00	4,28
4	Të hyra nga inspekcioni	100.000,00	1,25	150.000,00	1,28
5	Shfrytëzimi sip. publike	1.000.000,00	12,50	700.000,00	5,99
6	Transakcioni i pronës	490.000,00	6,13	600.000,00	5,14
7	Licenca në biznes	570.000,00	7,13	1.000.000,00	8,56
8	Leje ndërtimi	3.000.000,00	37,50	4.500.000,00	38,52
9	Tatimi në pronë	1.968.000,00	24,60	3.000.000,00	25,68
10	Participime/Donacione	-	-	400.000,00	3,42
11	Të hyra nga trafiku	500.000,00	6,25	633.000,00	5,42
12	Renta	-	-	-	-
			100,00		100,00
	<b>TOTALI</b>	<b>8.000.000,00</b>		<b>11.683.000,00</b>	

Nga të hyrat vetanake komunale buxhetore me përqindje më të lartë në arkëtimin e të hyrave prin të hyrat nga urbanizmi-lejet e ndërtimit me rreth 38.5%, tatimi mbi pronën 25.6% dhe të hyrat nga licenca në biznes me 8.5%, por shikuar në aspektin e numrit të pronave për të cilat duhet të paguhet tatim mbi pronë dhe nevojat për pajisje me leje ndërtimi si dhe numrin e bizneseve të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme e që duhet të pajisen me leje pune në territorin e Komunës së Prishtinës vlerësojmë se qeveria komunale mund të sigurojë të hyra edhe me një përqindje edhe më të lartë nga këto lloje të hyrave. Për të parë në mënyrë me të qartë krahasimet e planifikimit të të hyrave vetanake komunale sipas llojit do t'i paraqesim në bazë të grafikut nr.1 sipas lakores.

### 6. Analiza e shpenzimeve të të hyrave vetanake për periudhën Janar-Shtator 2007

Në bazë të raporteve të nxjerra nga të dhënat e buxhetit të shpenzuar dhe alokuar për periudhën 9 mujore, i cili buxhet është siguruar nga të hyrat vetanake është vërejtur se nga gjithsej 7.0 milion euro sa ka qenë janë shpenzuar vetëm 1.7 milion euro apo vetëm rreth ¼ e këtij buxheti. Buxheti i shpenzuar dhe alokuar për periudhën 9 mujore sipas kategorive ekonomike, të siguruar nga të hyrat vetanake komunale do ta paraqesim në tabelën nr.5.

Tabela 5;Mjetet e alokuara dhe të shpenzuara për periudhën Janar-Shtator 2007 nga të hyrat vetanake

Kategoritë ekonomike	Buxheti	Alokimet	Shpenzimet	Aloke pa shpenzuara
Pagat	245.000,00	216.621,50	74.097,67	142.523,83
Mallra dhe shërbime	1.030.000,00	495.687,03	329.573,42	166.113,61
Shpenzime komunale	25.000,00	25.000,00	20.298,96	4.701,04
Subvencione	300.000,00	300.000,00	275.359,00	24.641,00
Shpenzime kapitale	5.400.000,00	5.299.999,64	1.045.734,11	4.254.265,53
<b>TOTALI</b>	<b>7.000.000,00</b>	<b>6.337.308,17</b>	<b>1.745.063,16</b>	<b>4.592.245,01</b>

Nga të dhënat e prezantuar në tabelën nr.5 mund të vërehet se përveç në kategoritë e shpenzimeve komunale dhe subvencione, ku është shpenzuar mbi 80 % e buxhetit të alokuar në kategoritë e pagave dhe mallrave e shërbimeve kemi një ngecje në realizimin e shpenzimeve sipas buxhetit të alokuar, ndërsa ngecjet edhe më të mëdha mund të vërehen tek kategoria e shpenzimeve kapitale ku nga gjithsej 5.2 milion euro të alokuar në këtë periudhë janë shpenzuar vetëm 1.0 milion euro. Më këtë gjendje të prezantuar mund të vlerësojmë se kemi një ngecje në realizimin e projekteve kapitale, projekte të cilat do të ndikonin në zhvillimin e infrastrukturës së Komunës së Prishtinës dhe krijimin e kushteve sa më të mira për qytetarët e kësaj komune. Për të pasur me të qartë se në cilat kategori të shpenzimeve kemi buxhetin me të lartë të alokimeve të pasqyruar në grafikun nr.2 mund të kuptohet dhe pasqyrohet më mirë.



Grafiku 5; Alokimet e pashpenzuara të buxhetit për periudhën 9 mujore sipas kategorive ekonomike

Nga ky grafik vërehet se përqindja më e lartë e alokimeve të pashpenzuara sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve është tek shpenzimet kapitale me 92 %, pastaj mallrat dhe shërbimet me 4% etj. Mund të vlerësojmë se kemi një ngadalësim të implementimit të projekteve të planifikuara për t'u realizuar nga këto mjete buxhetore.


## 7. Analiza e shpenzimeve të mjeteve buxhetore të planifikuara Janar-Shtator 2007

Në bazë të raporteve të nxjerra nga të dhënat e buxhetit të shpenzuar dhe alokuar për periudhën 9 mujore të buxhetit të siguruar nga grantet ndërqeveritare, mund të vlerësojmë se në disa programe apo drejtori buxheti është shpenzuar sipas alokimeve dhe nuk ka mbetje të alokimeve të pashpenzuar, ndërsa tek disa programe ka diferencë të larta rreth buxhetit të alokuar dhe atij të shpenzuar gjatë kësaj periudhe 9 mujore. Buxheti i shpenzuar dhe alokuar për periudhën 9 mujore sipas kategorive ekonomike, të siguruar nga grantet ndërqeveritare do ta paraqesim në tabelën nr.6.

Tabela 6; Buxheti alokuar, shpenzuar dhe alokimet e pashpenzuara Janar-Shtator 2007 nga grantet

Kategoritë ekonomike	Buxheti	Alokimet	Buxheti pa Shpenzimet alokuar	Alokimet e pa shpenzuara	Buxheti i pashpenzuar
Pagat	11.739.145,00	8.819.885,64	2.919.259,86	7.687.212,99	4.051.932,51
Mallra dhe sherbime	3.025.571,00	2.353.244,26	672.326,74	2.777.869,93	247.701,07
Shpenzime komunale	1.380.009,00	1.147.756,67	232.252,33	1.076.745,98	303.263,02
Subvencione	205.000,00	205.000,00	-	122.356,50	82.643,50
Shpenzime kapitale	2.950.651,00	2.950.651,00	-	245.551,37	2.705.099,63
<b>TOTALI</b>	<b>19.300.376,00</b>	<b>15.476.537,57</b>	<b>3.823.838,93</b>	<b>11.909.736,77</b>	<b>7.390.639,73</b>

Nga të dhënat në tabelën nr.6 dhe analizës të shpenzimeve dhe alokimeve në periudhën 9 mujore, mund të vlerësojmë se përveç në kategorinë e shpenzimeve në mallra dhe shërbime ku kemi tejkalim të shpenzimeve në bazë të alokimeve tek të gjitha kategoritë tjera ekonomike të shpenzimeve është vërejtur ngecje në realizimin e buxhetit në bazë të alokimeve. Kjo ngecje është shumë e theksuar tek kategoria ekonomike shpenzimet kapitale, P.sh buxheti i alokuar është shpenzuar vetëm 8 %, për këtë periudhë. Arsyet më të përgjithshme rreth pamundësisë së shfrytëzimit të buxhetit në këtë kategori të shpenzimeve ju referohen procedurave të zgjatura të prokurimit dhe afateve kohore të shpërndarjes së mjeteve nga MEF-i, dhe që pamundëson fillimin e projekteve sipas afateve të caktuara. Krahasimin në mes të buxhetit të aprovuar dhe të shpenzuar për periudhën 9 mujore sipas kategorive ekonomike do ta paraqesim në grafikun nr.6



Grafiku 6 ; Buxheti i alokuar dhe shpenzuar për periudhën 9 mujore Janar-Shtator 2007

Pra grafiku pasqyron qartë se tek kategoria e shpenzimeve ekonomike Mallra dhe Shërbime kemi tejkalim të shpenzimeve, ndërsa sa i përket krahasimeve në mes të alokimeve dhe shpenzimeve diferenca më e lartë ekziston tek kategoria e shpenzimeve kapitale.

- Nga analizat e bëra të shpenzimeve dhe alokimeve nga burimet e ndryshme të financimit të buxhetit për Komunën e Prishtinës vlerësojmë se në kategorinë e shpenzimeve ekonomike të Pagave dhe Shtesave buxheti është shpenzuar pothuajse sipas rrjedhës së planifikuar të parasë. Duhet përmendur se tek disa programe apo drejtoritë ka ngecje në realizimin e buxhetit sipas alokimeve të bëra në periudhën Janar-Shtator 2007.
- Planifikimet për uljen e shpenzimeve dhe reduktimet në një përqindje të caktuar të buxhetit në disa programe për kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime dhe ngritja e përqindje në kategorinë e shpenzimeve kapitale, duket vetëm sa janë deklarative nga qeveria komunale. Nga të dhënat në dispozicion të buxhetit të alokuar dhe shpenzuar për periudhën 9 mujore është vërejtur se në këtë kategori të shpenzimeve kemi një tejkalim të shpenzimeve të buxhetit të alokuar.
- Sa i përket shpenzimeve komunale edhe në këtë kategori të shpenzimeve kemi diferenca të vogla në mes të alokimeve dhe shpenzimeve sipas dinamikës së rrjedhës së parasë, por është vërejtur se në disa programe apo drejtoritë ka nevojë për t'u përmirësuar raporti në mes të alokimeve dhe shpenzimeve.
- Shikuar në pjesëmarrjen e përgjithshme të buxhetit të kategorisë së shpenzimeve Subvencione, ku për një komunë siç është Prishtina me një numër të banorëve mbi gjysmë milioni, buxheti i ndarë për këtë kategori ka qenë në nivel shumë të ulët. Sa i përket realizimit të buxhetit sipas alokimeve mund të vlerësojmë se nuk ka pasur diferencë të madhe në mes të buxhetit të alokuar dhe shpenzuar për këtë periudhë.
- Investimet kapitale janë një ndër kategoritë e buxhetit, buxheti i të cilave shfrytëzohet për realizimin e projekteve të ndryshme për zhvillimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve sa më të mira të qytetarëve. Shumica e buxhetit të kësaj kategorie sigurohet nga të hyrat vetanake të komunës, e cila përmes mbledhjes së taksave nga qytetarët mund të investojë në projekte të ndryshme. Edhe pse në planifikimet e qeverisë lokale ishte planifikuar fillimi i realizimit të disa projekteve nga muaji i tretë i këtij viti, analizat tona bëjnë të njohur se nga raportet e nxjerra në bazë të alokimeve dhe shpenzimeve të mjeteve buxhetore për këtë kategori të shpenzimeve për periudhën 9 mujore kemi një diferencë shumë të madhe në bazë të buxhetit të alokuar dhe shpenzuar. Ndër arsyeshmëritë e ngecjes së fillimit me kohë të realizimit të projekteve të ndryshme kapitale janë vonesat në alokimin e mjeteve me kohë nga MEF-i dhe procedurat e shumta të respektimit të ligjit të prokurimit, por ne mendojmë se mosrealizimin e buxhetin të alokuar në një përqindje kaq të lartë në këtë kategori të shpenzimeve nuk mund t'i arsyetojmë menaxherët e KK së Prishtinës. Nga kjo mund të vlerësojmë se kemi të bëjmë me keq menaxhim të fondeve të ndarë për këtë kategori të shpenzimeve.
- Shikuar projeksionet në planifikimin e të hyrave kemi një politikë fiskale drejt pavarësisht të sigurimit të buxhetit, duke zvogëluar varësinë nga grantet ndërqeveritare dhe ngritur realizimin e të hyrave nga burimet vetanake. Nëse komuna do të arrijë që në vazhdimësi të ngrit përqindjen e sigurimit të buxhetit nga të hyrat vetanake atëherë, mund të konsiderojmë se ka arritur qëllimet e saj.

- Komuna e Prishtinës duhet të vazhdojë me ngritjen e përqindjes në sigurimin e buxhetit nga të hyrat vetanake dhe zvogëlimin e varësisë nga grantet ndërqeveritare, duke intensifikuar aktivitetet në mbledhjen e taksave të ndryshme nga qytetarët si dhe nxjerrjen e rregulloreve të ndryshme, për ngritjen e të hyrave vetanake përmes aplikimit të metodave të reja në ngritjen e përqindjes së realizimit të taksave dhe tatimeve të ndryshme.
- Për shkak të keq menaxhimit dhe mosrealizimit të buxhetit sipas alokimeve të bëra ne mendojmë se Komuna e Prishtinës duhet ta përmirësojë menaxhmentin e saj sa i përket planifikimit strategjik dhe zhvillimit të sistemit më të mirë të menaxhimit financiar.
- Është e nevojshme që të bëhet rishikimi dhe përmirësimi i distribuimit të mjeteve buxhetore në mes të programeve dhe ndarja e mjeteve buxhetore në bazë të prioriteteve të përcaktuara të komunës në mënyrë që objektivat e planifikuara për t'u realizuar të janë të financuara.
  - Duke marrë parasysh pengesat e realizimit të projekteve kapitale në afatet e caktuara në mënyrë që në kategorinë e shpenzimeve kapitale mos të kemi një diferencë të madhe në mes të buxhetit të alokuar dhe të shpenzuar, duhet të kërkohet nga MEF-i që alokimin e mjeteve të bëjë sipas kërkesave të KK së Prishtinës. Njëkohësisht në fillim të çdo viti duhet të bëhen përgatitjet dhe sigurimi i të gjitha dokumentacioneve për zhvillimin e procedurave të tenderimit.
- Komuna e Prishtinës duhet të rishikoj nivelin e financimit nëpër kategoritë ekonomike të shpenzimeve përveç kapitaleve dhe këtë t'i përshtatë nevojave të domosdoshme për financim nëpër secilin program, ndërsa për disa kategori të shpenzimeve brenda mallrave dhe shërbimeve duhet të bëjë reduktimet e nevojshme.
- Për shkak të shpërndarjes më të mirë të buxhetit komunal, Komuna e Prishtinës duhet të marrë parasysh edhe hartimin e buxhetit me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit. Në projekt buxhetin komunal për këtë vit askund nuk është cekur se sa janë marr parasysh kërkesat e komunitetit dhe si janë futur prioritetet e tyre në buxhetin vjetor.

- Projekt propozimi i buxhetit të KK Prishtinë për vitin 2007
- Raporti i mjeteve të alokuara dhe shpenzuar për janar-shtator 2007
  - Libri i buxhetit 2006 dhe 2007 i botuar nga MEF-i
  - Planifikimi i të hyrave buxhetore vetanake për vitin 2006-2007

# IZVEŠTAJ TROSKOVA

januar - septembar 2007

OSPTINA PRISTINE

Izveštaj je izdat na osnovu Projekta: “Javni Novac-Javnosti”. Projekt je financiran od strane USAID/IREX unutar programa civilne Javnosti, koja se implementira od ATRC. Ovaj Projekat je realizovan od NVO Novi Milenijum sa sedištem u Prištini.

**Izveštaj je spremljen od:**  
Mentor Morina

**Prevod:**  
Albanski/Srpski:  
Fanol Shehu

